# Formular për syllabus të lëndës

| Të dhëna bazike të lëndës | |
|---|---|
| **Njësia akademike:** | FAKULTETI I ARTEVE |
| **Titulli i lëndës:** | **IMAZHET DIXHITALE DHE MEDIAT E REJA II** |
| **Niveli:** | BA |
| **Statusi lëndës:** | OBLIGATIVE |
| **Viti i studimeve:** | VITI IV - SEMESTRI VII DHE VIII |
| **Numri i orëve në javë:** | 4 |
| **Vlera në kredi – ECTS:** | 6 |
| **Koha / lokacioni:** | Fakulteti i Arteve - Studio e Fotografisë |
| **Mësimdhënësi i lëndës:** | Prof. Ast. Yllka Fetahaj |
| **Detajet kontaktuese:** | yllka.fetahaj@uni-pr.edu |
| | |
| **Përshkrimi i lëndës** | Lënda "Imazhet Dixhitale dhe Mediat e Reja II" thekson lidhjen midis ngjyrës, emocionit dhe komunikimit vizual në kontekstin e fotografisë bashkëkohore. Studentët eksplorojnë mënyrën se si ngjyra ndikon në përceptim, ndjenjë dhe kuptim, si dhe zhvillojnë projekte që lidhin teorinë me praktikën.<br><br>Në pjesën e dytë të kursit, fokusi zhvendoset te **projekti përfundimtar**, **puna praktike profesionale** dhe **ekspozita e diplomës**, duke e përgatitur studentin për prezantim profesional dhe hyrje në tregun e punës. |
| **Qëllimet e lëndës** | - Të zhvillojë kuptimin teorik dhe praktik të ngjyrës si mjet komunikues dhe emocional.<br>- Të aftësojë studentët në përdorimin strategjik të ngjyrës në kontekste të ndryshme fotografike.<br>- Të përgatisë studentët për krijimin e një projekti final dhe prezantimin e tij profesional.<br>- Të nxisë mendimin kritik dhe pavarësinë artistike përmes kërkimit dhe praktikës profesionale. |
| **Rezultatet e pritura të nxënies:** | Pas përfundimit të kursit, studenti do të jetë në gjendje të:<br><br>- Aplikojë teorinë e ngjyrës në mënyrë estetike dhe psikologjike në fotografi.<br>- Zhvillojë projekte që lidhin emocionin, temën dhe ngjyrën me shprehje personale.<br>- Njohë dhe analizojë zhanret kryesore të fotografisë bashkëkohore. |

| | |
|---|---|
| | - Përgatisë një portofolio profesionale dhe ta prezantojë atë publikisht në ekspozitë. |

| **Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)** | | | |
|---|---|---|---|
| **Aktiviteti** | **Orë** | **Ditë** | **Gjithsej** |
| Ligjërata | 2 | 1 | 30 orë |
| Ushtrime teorike | - | - | - |
| Ushtrime praktike (studio/laborator) | 1 | 1 | 15 orë |
| Ushtrime në teren | 1 | 1 | 15 orë |
| Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet | 0.5 | - | 10 orë |
| Kollokfiume, seminare | - | 2 | 5 orë |
| Detyra të shtëpisë | 1 | - | 30 orë |
| Koha e studimit vetanak të studentit | 2 | - | 60 orë |
| Përgatitja përfundimtare për provim | - | - | 10 orë |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final) | - | - | 5 orë |
| Projektet, prezantimet, etj | - | - | 25 orë |
| **Totali** | 205 orë | | |

**Shpjegim i shkurtër i përllogaritjes:**

- **4 orë mësim në javë** × 15 javë = **60 orë kontakti** (30 ligjërata + 15 praktikë + 15 terren).
- Pjesa tjetër është shpërndarë sipas standardeve akademike për punë vetanake, ushtrime dhe projekte.
- **Kjo është e përputhshme me një kurs që ka 6 ECTS**, pasi 1 ECTS = ~25–30 orë ngarkesë pune.

| | |
|---|---|
| **Metodologjia e mësimdhënies:** | Metodologjia e mësimdhënies për këtë kurs bazohet në një qasje të integruar që kombinon **teorinë, praktikën, analizën vizuale dhe zhvillimin e projekteve fotografike konceptuale dhe profesionale**.<br><br>Procesi i mësimdhënies zhvillohet në mënyrë progresive – nga reflektimi mbi **ngjyrën, emocionin dhe estetikën vizuale**, deri te zbatimi i tyre në **projektin përfundimtar dhe portofolion profesionale**.<br><br>**Ligjërata interaktive me analiza vizuale**<br><br>- Parashtrimi i koncepteve teorike për ngjyrën, emocionin dhe komunikimin vizual në fotografinë bashkëkohore.<br>- Analiza e punëve të autorëve që përdorin ngjyrën si mjet shprehës dhe rrëfimor. |

| | |
|---|---|
| | - Diskutim kritik mbi rolin e imazhit digjital në mediat e reja dhe në procesin e krijimit artistik.<br><br>**Punë praktike dhe projekte individuale / në grup**<br><br>- Studentët realizojnë projekte përmes fazave të: **kërkimit, planifikimit, fotografimit, editimit digjital dhe prezantimit profesional.**<br>- Puna praktike përfshin detyra që lidhen me ngjyrën, tipet e fotografisë dhe zhvillimin e një **projekti final të personalizuar**.<br>- Projektet zhvillohen individualisht dhe në grup, duke inkurajuar pavarësi krijuese dhe bashkëpunim.<br><br>**Workshop-e dhe ushtrime eksperimentale**<br><br>- Seanca intensive mbi temat: **ngjyra si ndjenjë, harmonia dhe kontrasti, tipet e fotografisë, zhvillimi i projektit final dhe përgatitja për ekspozitë.**<br>- Eksperimentim me dritë, ngjyrë dhe formë për të zbuluar mundësi të reja vizuale dhe emocionale.<br>- Përdorimi i mjeteve digjitale dhe ndriçimit në studio për të krijuar **imazhe ekspresive dhe konceptuale**<br><br>**Kritikë dhe feedback formativ**<br><br>- Studentët paraqesin rregullisht punët e tyre përmes **kritikave të hapura dhe të strukturuara**, duke marrë feedback nga mësimdhënësi dhe kolegët.<br>- Qëllimi është **reflektimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm**, me fokus në zhvillimin personal dhe profesional.<br>- Kritika vizuale është pjesë e vlerësimit formativ gjatë gjithë semestrit.<br><br>**Analizë vizuale dhe kërkim konceptual**<br><br>- Zhvillimi i aftësisë për të **lexuar, interpretuar dhe ndërtuar imazhe me bazë konceptuale.**<br>- Hulumtim mbi **ngjyrën si përvojë emocionale** dhe përdorimin e saj në lloje të ndryshme të fotografisë.<br>- Përdorimi i referencave teorike dhe vizuale për të ndërtuar një **projekt të argumentuar dhe të personalizuar.**<br><br>**Përdorimi i teknologjive digjitale** |

<table>
<tr><td></td><td>
- Ushtrime që zhvillojnë aftësitë në përpunim, retouching dhe prezantim profesional të punës (Lightroom, Photoshop, InDesign).<br>
- Integrimi i mjeteve digjitale në dizajnimin e portofolios dhe përgatitjen e ekspozitës finale.<br>
- Përdorimi i softuerëve për simulime ndriçimi dhe kompozimi, duke e lidhur praktikën me standardet bashkëkohore.<br><br>
Prezantime të strukturuara dhe dokumentim i procesit<br><br>
- Studentët mësojnë të artikulojnë dhe prezantojnë procesin e tyre krijues në mënyrë profesionale – vizualisht dhe me shkrim.<br>
- Përdorimi i portofolios si mjet dokumentimi dhe vlerësimi të progresit teknik e konceptual.<br>
- Dokumentimi i vazhdueshëm i punës në studio, terren dhe gjatë procesit të përgatitjes së ekspozitës finale.
</td></tr>
<tr><td>Metodat e vlerësimit:</td><td>
Vlerësimi në këtë lëndë bazohet në një kombinim të vlerësimit formativ dhe përfundimtar, me fokus në zhvillimin teknik, estetik dhe konceptual të studentit gjatë gjithë procesit krijues.<br>
Qëllimi është të vlerësohet jo vetëm rezultati final, por edhe procesi i punës, përfshirja aktive në diskutime, reflektimi kritik dhe aftësia për të zhvilluar një qasje personale në fotografi.<br>
- Pjesëmarrja dhe angazhimi në ligjërata dhe praktikë – 20%<br>
- Detyra praktike dhe ushtrime individuale – 30%<br>
- Projekti final / ekspozita – 50%
</td></tr>
<tr><td colspan="2">Literatura</td></tr>
<tr><td>Literatura bazë:</td><td>
James Fox – The World According to Colour: A Cultural History<br>
Philip Ball – Bright Earth: Art and the Invention of Color<br>
Charlotte Cotton – The Photograph as Contemporary Art<br>
to Photographic Lighting<br>
Bruce Barnbaum: The Art of Photography
</td></tr>
<tr><td>Literatura shtesë:</td><td>
David duChemin – Within the Frame: The Journey of Photographic Vision<br>
Roland Barthes – Camera Lucida: Reflections on Photography<br>
Susan Sontag – On Photography
</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet:<br>
https://www.biblioteka-ks.org/<br>
https://bibliotekadigjitale-ks.org/documents<br>
https://uni-pr.edu/page.aspx?id=1,137<br>
https://www.gutenberg.org/<br>
https://www.springer.com/gp/open-access/books<br>
https://doabooks.org/
</td></tr>
</table>

| |
|---|
| https://www.magnumphotos.com/<br>https://aperture.org/<br>https://lensculture.com/<br>https://www.tate.org.uk/art/art-terms/p/photography<br>https://photoresourcehub.com/<br>https://masters-of-photography.com/ |

| Java | Tema / Njësia Mësimore | Përmbajtja Kryesore | Aktivitetet Mësimore | Detyra / Vlerësimi |
|---|---|---|---|---|
| ***1*** | ***Hyrje në lëndë dhe prezantimi i syllabusit*** | Prezantimi i planit, metodologjisë dhe mënyrës së vlerësimit. | Diskutim hyrës, prezantim lënde | Ditar reflektiv |
| ***2*** | ***Roli i ngjyrës në përceptimin vizual*** | Kuptimi i ngjyrës si gjuhë vizuale dhe psikologjike. | Ligjëratë dhe analiza vizuale | Pjesëmarrje aktive |
| ***3*** | ***Book Presentation – The World According to Color*** | Diskutim mbi librin e James Fox dhe mënyrën si ngjyra lidhet me kulturën dhe përvojën njerëzore. | Prezantime individuale | **Detyra 1.** Prezantim i studentit (vlerësim formativ) |
| ***4*** | ***Teoria e ngjyrave*** | Kuptimi i bazave të teorisë së ngjyrave dhe se si ngjyrat ndërveprojnë mes tyre në fotografi. | Ligjëratë teorike + ushtrime me shembuj vizualë | **Detyra 2.** *Teoria e ngjyrave* |
| ***5*** | ***Vazhdim: Teoria e ngjyrave*** | Eksperimentim me përdorimin e ngjyrave primare dhe komplementare në studio dhe terren për të krijuar efekte të ndryshme vizuale. | Ushtrime praktike ne terren. | Realizim ushtrimi me kombinime ngjyrash |
| ***6*** | ***Vazhdim: Teoria e ngjyrave*** | Eksperimentim me përdorimin e ngjyrave terciale dhe analoge në studio dhe terren për të | Ushtrime praktike ne terren. | Ushtrime praktike |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | krijuar efekte të ndryshme vizuale. | | |
| ***7*** | ***Kritika vizuale e punëve*** | Diskutim kolektiv për rezultatet. | Prezantim dhe analizë | Feedback formativ |
| ***8*** | ***Color as Emotion*** | Krijimi i serive fotografike që shprehin ndjenja përmes dritës dhe ngjyrës. | Punë praktike në studio dhe terren | **Detyra 3.** Realizim serie me temë "Ngjyra si ndjenjë" |
| ***9*** | ***Kritikë vizuale dhe reflektim mbi ngjyrën si mjet rrëfimor*** | Diskutim mbi rezultatet dhe interpretimin personal. | Prezantime dhe analizë | Feedback formativ |
| ***10*** | ***Shikim filmi dhe Esseja fotografike*** | Shikimi i një filmi dhe analiza e ngjyrave në projekte filmike | Diskutim reflektiv me studentët. | **Detyra 4:** Esseja fotografike nga filmi |
| ***11*** | **Prezantim** | Analize dhe diskutim rreth përdorimit të ngjyrave në film për të kuptuar se si ato ndikojnë në emocionet dhe mesazhet vizuale. | Prezantim + kritikë | Prezantim |
| ***12*** | ***Vizita në galeri ose studio*** | Njohje me praktikën bashkëkohore të fotografisë. | Vizitë studimore | Ditar reflektiv |
| ***13*** | ***Tipet e fotografisë*** | Prezantimi i zhanreve të ndryshme të fotografisë, pionerët dhe aplikimi praktik | Ligjëratë teorike me analiza vizuale | **Detyra 5:** *Tipet e fotografisë* |
| ***14*** | ***Vazhdim: Tipet e fotografisë*** | Studentët do të aplikojnë aftësitë e tyre në zhanret kryesore | Ushtrime praktike ne terren dhe studio. | Ushtrime praktike |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | duke realizuar mini-projekte për secilin zhanër. | | |
| ***15*** | **Prezantim** | Prezantim i serive paraprake te tipeve te fotografise | Prezantim + kritikë | Prezantim |
| ***16*** | ***Përmbyllje e semestrit të parë*** | Analizë e punëve të realizuara dhe planifikim për semestrin e dytë. | Kritikë kolektive | Vlerësim semestral I |
| ***17*** | ***Qasja në tregun e punës Post-graduation*** | Diskutim mbi qasjet për të hyrë në tregun e punës pas diplomimit. | Diskutim | **Detyra 6.** Puna Praktike (Internship) |
| ***18*** | ***Puna Praktike*** | Përgatitja për prezantime, intervista dhe negociata për kontrata. | Simulim interviste | Ushtrime |
| ***19*** | ***Zhvillimi i portfolios profesionale*** | Përzgjedhja e punëve, dizajni dhe paraqitja vizuale. | Mentorim individual | Fillimi i portofolios |
| ***20*** | ***Vazhdim: Zhvillimi i portfolios profesionale*** | Përzgjedhja dhe organizimi i materialeve për prezantim. | Mentorim individual | Punë individuale |
| ***21*** | ***Prezantimi i portfolios personale*** | Prezantimi i portofolios digjitale. | Ushtrime praktike | Vlerësim portfolio |
| ***22*** | ***Final Photographic Project*** | Realizimi i projektit final fotografik, duke përdorur teknikat e avancuara të mësuara gjatë viteve të studimit. | Punë praktike + konsultime | **Detyra 7.** Final Photographic Project |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| ***23*** | ***Vazhdimi i punës praktike në projekt*** | Zhvillimi i projektit personal bazuar në temën e miratuar. | Mentorim individual | Punë individuale |
| ***24*** | ***Kritikë vizuale e progresit*** | Fotografim në terren ose studio sipas konceptit. | Mentorim individual | Feedback formativ |
| ***25*** | ***Konsultime për projektin përfundimtar*** | Prezantim i serive paraprake dhe diskutim në grup. | Kontroll teknik dhe estetik i serive finale. | Feedback formativ |
| ***26*** | ***Reflektim mbi përvojën profesionale*** | Diskutim mbi aftësitë e fituara gjatë praktikës. | Prezantime në klasë | Diskutim |
| ***27*** | ***Përgatitja e prezantimit final*** | Simulimi i prezantimit para panelit | Praktikë e folurit dhe strukturimit | Provë prezantimi |
| ***28*** | ***Ekspozita e punëve studentore*** | Kurim, Organizim, montim dhe prezantim publik. | Punë kolektive | Pjesëmarrje aktive |
| ***29*** | ***Prezantimi final i projektit*** | Prezantim profesional para klasës / stafit | Prezantim + kritikë | Vlerësim i projektit final |
| ***30*** | ***Mbyllja e kursit dhe feedback i përgjithshëm*** | Rishikim i njësive mësimore, komente për përmirësim të ardhshëm | Reflektim në grup | Mbyllje administrative |

| **Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:** |
|---|
| Pjesëmarrja në ligjërata, ushtrime praktike dhe punë në terren është **e obligueshme**. Studentët pritet të jenë të përgatitur për çdo orë, të marrin pjesë aktivisht në diskutime dhe të dorëzojnë detyrat e tyre **brenda afateve të përcaktuara**. Pjesëmarrja në **kritikat vizuale**, diskutimet kolektive dhe prezantimet publike është pjesë përbërëse e procesit të vlerësimit.<br><br>Mësimdhënësi është në dispozicion për **konsultime individuale dhe grupore**, për të sqaruar aspektet teknike dhe konceptuale të punës fotografike. Studentët **inkurajohen të kërkojnë sqarime** gjatë orëve dhe të marrin iniciativë në procesin e tyre krijues. |

Pas çdo ligjërate, studentët duhet të lexojnë **materialet e rekomanduara** dhe të përgatisin ushtrimet që lidhen me temën javore. Në kuadër të lëndës, kërkohet **përgjegjësi individuale, respekt për pajisjet fotografike dhe kujdes gjatë punës në studio dhe laborator. Plagjiatura dhe manipulimi joetik i imazhit nuk lejohen.**

Studentët duhet të respektojnë orarin, të jenë të rregullt në vijim, dhe të tregojnë sjellje profesionale gjatë ligjëratave, ushtrimeve dhe prezantimeve.